




KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Data:	14.08.2024
Për:	MEDIA
CC	Z. Ismet Vrapçani Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nga:	Fadil Berisha – UD. Kryeshef Ekzekutiv në KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.a. Prizren
Tema:	KOMUNIKATË PËR MEDIA

Me datë 06.08.2024, duke u bazuar në ankesat e shumta për mungesë të ujit në 14 fshatrat të cilat furnizohen nga burimi i “SOZI”, ekipet e K.R.U. “Hidroregjioni-Jugor” menjëherë kanë dalë në teren për të inspektuar burimin e ujit SOZI dhe defektet e mundshme që mund të ndikojnë në mungesën e furnizimit me ujë nga ky burim.

Ekipi tona kanë konstatuar rënie drastike të nivelit të ujit në kaptazhë.

Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike kemi kontaktuar organet kompetente komunale dhe bashkërisht kemi dalë në vend të ngjarjes.

Sipas gjendjes faktike në teren, bazuar edhe në ekspertizën e ekspertëve të Kompanisë por edhe ekspertëve të tjerë të profesionit, është konstatuar që, punimet që janë duke u zhvilluar për rregullimin e shtratit të lumit, i cili ndodhet në afërsi të burimit, kanë dëmtuar pellgun ujëmbledhës të burimeve të Sozit. Në Nashec.

Si pasojë e dëmtimit të kaptazhes, (mbi 80%) janë shkaktuar probleme serioze të furnizimit për fshatrat;

Planej, Gorozhub, Mile, Mazrek, Gjonaj, Grzhdanik, Nashec, Landovicë, Tupec, Atmaxhë, Kobaj, dhe Vlashnj.

Pas konsultimeve profesionale nga i gjithë stafi profesional i KRU-se dhe profesionalistëve të fushës në nivel të Kosovës, kemi përgatitur urgjentisht një projekt për zgjidhje të përkohshme urgjente, me qëllim kryesorë, Aftësimin e përkohshëm të pellgut ujëmbledhës të Burimit SOZI në Nashec.

Pas përfundimit të gjitha procedurave ligjore të prokurimit, kemi nënshkruar kontratën me një operator ekonomik me qëllim të përfundimit sa më të shpejtë të punimeve.

Stafi i Kompanisë tona kanë qenë gjatë tërë kohës në mbështetje të operatorit ekonomik, me qëllim të realizimit sa më të shpejtë dhe sa më cilësorë të punimeve të parapara.



Ne si Kompani jemi angazhuar maksimalisht që të furnizojmë pjesërisht konsumatorët me ujë të pijes, me kapacitetet ekzistuese, duke praktikuar orare te reduktimeve por edhe duke furnizuar pjesërisht edhe me autocisterna.

Sot me date 14.08.2024 kemi arritë që të përfundojmë me sukses punimet në Aftësimin e përkohshëm te pellgut ujëmbledhës te Burimit SOZI në Nashec.

Paraprakisht kemi kërkuar që të bëhen analizat e kualitetit të ujit të pijes. Pas marrjes se rezultateve pozitive, te analizave fiziko-kimike dhe Mikrobiologjike, kemi filluar furnizimin e rregullt me ujë të pijes, pjesërisht nga dje (13.08.2024) pasdite dhe sot me kapacitet të plotë. Ne emër te KRU „Hidroregjioni Jugor” falënderojmë operatorin ekonomik, për angazhimin maksimal për te përfunduar punimet e parapara, edhe pse ne kushte aspak te favorshme Teknike. Falënderojmë te gjithë stafin Teknik, per angazhimin e tyre profesional, ne përgatitjen e tenderit, mbikëqyrjen dhe mbështetjen profesionale te operatorit ekonomik, te gjithë ekspertët e fushës profesionale për idetë e tyre profesionale, në veçanti Profesorin e nderuar Dr. Skender Bublakun.

Mbi te gjithë falënderojmë te gjithë konsumatorët për mirëkuptimin e tyre, gjate gjithë kësaj kohe.

Njoftojmë konsumatorët dhe opinionin që, ne si Kompani do te vazhdojmë aktivitet intensive, ne bashkëpunim te ngushte edhe me Kuvendin Komunal dhe Qeverinë e Kosovës për përgatitjen e një projekti sa ma profesional, për zgjidhjen afatgjate te problemit te burimeve SOZI ne Nashec,

Prizren
14.08.2024

Me Respekt

Fadil Berisha
UD- Kryeshef Ekzekutiv
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

